



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 04.11.2021

**NJOFTIM**

**ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE TË VITIT 2021**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 3 datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE, si dhe Urdhrit të Ministrisë nr. 331, datë 04.08.2021, “Për rialokimin e fondit të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2021”

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2021.

**Agropikat** janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve si dhe numrin e kodit të aplikimit që përfshihet mbi vijën e financimit.

- **Masa 1:** Tufa bazë e matriculluar – Vija e financimit ishte në numrin rendor 1902 për kodin e aplikimit me numër 3432 - Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 1903, për kodin e aplikimit me numër 3434.
- **Masa 2:** Parqet me koshere bletësh - Vija e financimit ishte në numrin rendor 763 për kodin e aplikimit me numër 4940– Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 768, për kodin e aplikimit me numër 4969.
- **Masa 3:** Zëvendësim plasmasi në sesa ekzistuese – Vija e financimit ishte në numrin rendor 608, për kodin e aplikimit me numër 12041 - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 626, për kodin e aplikimit me numër 12127.
- **Masa 4:** Mbjellje Bimë Aromatike dhe medicinale – Vija e financimit ishte në numrin rendor 117, për kodin e aplikimit me numër 1885 - Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 118, për kodin e aplikimit me numër 1909.

Fermerët të cilët iu përshihet aplikimi me fond të buxhetit të shtetit në datë **04.11.2021 për masën 3**, kanë afatin e dorëzimit të dokumenteve shtesë deri në datë **18.11.2021**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.